



Nr. _____ Prot. _____ Tiranë më _____. _____.
2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[____. _____.2020]

Për: **OPERATORIN EKONOMIK “I.D.K Konstruktion ” SHPK**
Tirane Vore , Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Rruga Zaja, Koder Berxulle,

Procedura e prokurimit: Pune/Procedure e Hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-35460-09-10-2019.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *“Punime ndërtimi për eliminimin e Pikave të Zeza në rrugë (Bashkëfinancim IPA 2013, Siguria Rrugore)”*

Fondi limit: 39.045.776,98 (tridhjetë e nentemilion e dyzet e pesemije e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë presje nenetëdhjetë e tete) lekë pa tvsh

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve datë 16 Shtator 2019 Nr [37]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE “BIBA-X” Sh.p.k dhe “LALA” Sh.p.k NUIS: K32618815N / J76418903B

Vlera: 33.006.341,55 leke pa tvsh. (tridhjetë e tre milion e gjashtë mijë e treqind e dyzete e nje presje pesëdhjetë e pese)



2. **JV "R.S & M+SI.SI-AL+NDREGJONI" NUIS: K32203002I / K72117030P / K31329048I**

Vlera: 37.093.471,28 leke pa tvsh (tridhjetë e shtatë milion e nentëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një presje njëzetë e tetë)

3. **JV "EVEREST" sh.p.k & "V.A.S Konstruksion" NUIS: J78311921L / L61322023P**

Vlera: 37.990.696,8 lekë pa tvsh. (tridhjetë e shtatë milion e netëqind e netëdhjetë mijë e gjashtëqind e netëdhjetë e gjashtë presje tetë)

4. **"I.D.K Konstruksion" Sh.p.k NUIS: K51408016J**

Vlera: 38.915.179,17 lekë pa tvsh. (tridhjetë e tetë milion e netëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e netë shtatëmbëdhjetë)

Jane skualifikuar ofertuesit e mëposhtem:

1. **BOE "BIBA-X" Sh.p.k dhe "LALA" Sh.p.k**
NUIS: K32618815N / J76418903B
2. **JV "R.S & M+SI.SI-AL+NDREGJONI"**
NUIS: K32203002I / K72117030P / K31329048I
3. **JV "EVEREST" sh.p.k & "V.A.S Konstruksion" sh.p.k.**
NUIS: J78311921L / L61322023P

Pikërisht për arsyet e mëposhtme:

I.Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "BIBA-X" Sh.p.k dhe "LALA" nuk kualifikohet, pasi rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

1Operatori ekonomik "LALA" SHPK nuk ka paraqitur dokumentacionin si me poshte vijon:

- Agim Dida ne profesionin mekanik prane shoqerise "LALA " SHPK nuk eshte i deklaruar ne Listepagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore per periudhen Janar, Mars 2019 dhe nuk ka arritur te paraqesë dëshmi kualifikimi profesional/diplomë të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm, duke mos plotesuar piken 2.3.3 dhe 2.3.6 te Kriteve të Veçanta të Kualifikimit.
- Dashamir Gjika saldator prane shoqerise "LALA" SHPK nuk eshte i deklaruar ne Listepagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore per periudhen Janar, Shkurt, Mars



2019 dhe nuk ka arritur të paraqesë dëshmi kualifikimi profesional/diplomë të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj që të vertetojë kualifikimin profesional të mesiperm, duke mos plotësuar piken 2.3.3 dhe 2.3.6 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

- Operatori ekonomik "Lala" Shpk ka deklaruar vlerën e kontributeve të mjekut Gani Sakajani për 10 dite pune në vlerën 13.000 leke, gjë e cila bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

I. Operatori ekonomik "BIBA-X" SHPK nuk ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

Drejtuuesi Teknik i "BIBA-X" Shpk, Ing. Hyqmet MUKA, është i tre punësuar. Ai është i punësuar pranë shoqërisë "BIBA-X" Shpk, pranë shoqërisë "KAZIU. B" Shpk, Nipt K83310801B dhe gjithashtu, është i punësuar pranë Bashkisë Kavaje, veprim, i cili është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Operatori ekonomik "BIBA-X" SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion të saktë siç është kërkuar në DST, por ka paraqitur vetëm Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik për specialistet si më poshtë, duke mos plotësuar piken 2.3.6 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

- Islam Emini saldator nuk është i deklaruar në Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore për periudhën Janar-Prill, Gusht 2019 dhe i mungon dëshmia e kualifikimit profesional/diploma të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj që të vertetojë kualifikimin profesional të mesiperm.
- Dashmir Uku specialist ndërtimi për beton nuk është i deklaruar në Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore për muajin Gusht 2019 dhe i mungon dëshmia e kualifikimit profesional/diploma të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj që të vertetojë kualifikimin profesional të mesiperm.
- Kujtim Dupi specialist ndërtimi për beton i mungon dëshmia e kualifikimit profesional/diploma të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj që të vertetojë kualifikimin profesional të mesiperm.
- Rajmond Biba elektrikist i mungon dëshmia e kualifikimit profesional/diploma të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj që të vertetojë kualifikimin profesional të mesiperm.
- Eduard Skuqi specialist ndërtimi për beton i mungon dëshmia e kualifikimit profesional/diploma të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj që të vertetojë kualifikimin profesional të mesiperm.
- Ervis Kurti manovrator për vijezim në asfalt nuk është i deklaruar në Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore për muajin Shkurt 2019.
- Sokol Habili manovrator për vijezim në asfalt nuk është i deklaruar në Listëpagesat e



Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore per muajin Mars 2019.

- Iris Carja manovrator per vijezim ne asfalt nuk eshte i deklaruar ne Listepagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore per muajin Korrik 2019.
- Migel Hoxha manovrator per vijezim ne asfalt nuk eshte i deklaruar ne Listepagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore per muajin Gusht 2019.
- Lorenc Bani Drejtues Teknik (Inxhinier Ndertimi) nuk eshte i deklaruar ne Listepagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore per muajin Prill 2019. Keshtu, BOE "BIBA-X" SHPK & "LALA " SHPK kane paraqitur deshmi kualifikimi te sigurimit teknik, te cilat leshohen nga subjekte juridike jo publike (privat).

Por keto deshmi te paraqitura nuk provojne se personat qe i disponojne ato jane ne profesionet e kerkuara.

Kjo, sepse nuk te ben elektrikist, mekanik, deshmia se je trajnuar per te perdorur pajisjet elektrike e dhene ndihmen e pare ne rast renie ne kontakt me rrymen elektrike, por zanatçi, specialist, profesionist te nje fushe te caktuar te ben shkolla apo kursi profesional.

Ne ndryshim nga kualifikimi per perdorimin e pajisjeve elektrike "Kualifikimi profesional " eshte nje sistem njohurish, aftesish, qendrimesh dhe vlerash, te cilat mundesojne ushtrimin me sukses te nje aktiviteti te caktuar profesional, i cili mund te perftohet nepermjet mesimnxenies te nje ofrues i Agjencise se Formimit Profesional, i permbyllur me provime dhe i çertifikuar nepermjet nje dokumenti perkates (çertifikate).

Dokumenti qe duhet paraqitur per te deshmuar kualifikimin profesional jane. Deshmite/diplomat, te cilat jane dokumente zyrtare te llojeve te ndryshme, te leshuara nga nje organ çertifikues, te cilat regjistrojne arritjet e nje individi pas vleresimit, sipas nje procedure e standardi te paracaktuar.

Keto Deshmi/diploma jane leshuar apo leshohen nga shkollat profesionale, apo qendrat e formimit profesional, te cilat jane njohur e akredituar ligjerisht nga Agjencia e Formimit Profesional sipas percaktimeve te ligjit Nr. 15/2017 "Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise" apo shkollat profesionale e qendrat e formimit qe kane ekzistuar ne Shqiperi deri ne hyrjen ne fuqi te ligjit Nr. 8872, date 29.3.2002 "Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise".

Skualifikimi per mosparaqitje deshmi kualifikimi profesional te leshuara nga shkolla apo qendra te formimit profesional te njohura nga shteti eshte praktike e konsoliduar e vendimmarjes se KPP, si Vendimi i KPP-se Nr. 975/2016, fq 7, Vendimi KPP-se Nr. 558/2018 duke rrezuar pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "AVDULI" SHPK ne te cilin citohet se:

"Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te



cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithçka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne keto kushte, operatori ekonomik ankimes nuk e permbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor ne piken 2.3.9 te shtojces 12, "Kapaciteti teknik", ne dokumentat standarde te tenderit te procedures se prokurimit objekt ankimi".

Per sa me siper, mosparaqitja e dokumentacionit si (deshmi kualifikimi profesional/diplome) te leshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale te njohura, apo te akredituara nga shteti, etj qe te vertetoje kualifikimin profesional te mesiperm konsiderohet mosplotesim i pikes 2.3.6 te Kriterëve të Veçanta për kualifikim nga operatori BOE "BIBAX" SHPK & "LALA" SHPK qe sipas akt-marreveshjes "BIBA-X" ka marre persiper te kryeje 76 % te punimeve DHE "LALA" SHPK 24 % te punimeve.

Në nenin 46, pika l/b, të Ligjit nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se [...]Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]"

Ndërsa në nenin 53 pika 3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar parashikohet se "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetem nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji".

BOE "BIBA-X" SHPK & "LALA" SHPK nuk kane paraqitur dokumentacionin perkates ne lidhje me makinerite/mjetet e kerkuara ne DST pika 2.3.11, si me poshte:

1. Makineri vijëzimi për bojë bikomponente paste (1 cope) nuk eshte paraqitur asnje dokument nga BOE per disponimin e kesaj makinerie.
2. Makineri për aplikim vijëzimi termoplastik, kapacitet mbajtës të bojës mbi 4.5 ton (2 cope) nuk eshte paraqitur asnje dokument nga BOE per disponimin e kesaj makinerie.



3. Batipal për vendosje për barrierë metalike janë kërkuar 2 cope dhe është paraqitur vetëm 1 cope nga "BIBA-X" SHPK

4. Kone plastike janë të shoqeruara thjesht me foto dhe ju mungon fatura tatimore perkatese.

5. Litar me çikrik profesional për vijëzim nuk është paraqitur asnjë dokument nga BOE.

IV. Oferta e paraqitur nga BOE "BIBA-X" SHPK & "LALA" është oferte e papergjegjshme pasi për të njëjtin zë punimi ka paraqitur çmime të ndryshme në preventiv si: Pikat e zeza K001 sinjalistika vertikale, pika 4, Panel informative 300x300 cm Al-C12, çmimi për njësi është dhënë 11.000 leke, ndërsa në preventivin Pikat e zeza TR09, sinjalistika Vertikale pika 4, Panel informative 300x300 cm A I-C 12, çmimi për njësi është ofruar 10.000 leke

Në preventivin Pikat e zeza DU07, Sinjalistika Vertikale pika 5 në preventivin e publikuar nga Autoriteti Kontraktor është Panel informative 300x300 cm Al-C 12, në ofertën e paraqitur nga ana juaj ky zë është ndryshuar në panel plotësues model 5 e madhe 25x25 kjo në kundërshtim me kërkesat dhe preventivin e publikuar nga autoriteti kontraktor.

II. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "EVEREST" sh.p.k & "V.A.S Konstruksion" sh.p.k nuk kualifikohet, pasi rezulton se nuk kanë paraqitur dokumentet në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit si më poshtë:

- Oferta ekonomike e paraqitur nga bashkimi i operatoreve "EVEREST" sh.p.k & "V.A.S Konstruksion" sh.p.k. rezulton me gabime aritmetike pikerisht.

Në preventivin Pikat e zeza DU09 / Sinjalistika Horizontale, pika 6 F. V reflector asfalti sasia 176 x çmimi për njësi 2500 nuk është 807.570 leke, por është 440.000 lekë. Totali i sinjalistikës horizontale nga I deri në 6 është 1.247.570 leke. Shuma Totali pikat e zeza DU09 është **2.591.248 leke**.

Në preventivin Pikat e zeza FR06 Totali i dhënë në ofertën tuaj është 3.093.646 leke ndërsa nga shumatorja Total sinjalistike Vertikale + Total sinjalistike Horizontale + Total nderhyrje në rrugë rezulton të jetë 942.398 leke.

Në preventivin Pikat e Zeza TROI, nderhyrje në rrugë pika 6 Struktura monolite betoni C20/25 (sasia 3 * çmimin për njësi 12500 nuk del 25500, por 37500 leke. Totali pikat e zeza TR01 është 2.542.534 lekë.

Shuma totale K001+BR02+GJ01+DU09+FR06+FR02+TR09+SH03+TR01+DU07 rezulton të jetë 34.482.368 jo 36.181.616 leke.

Sipas pikes 4, nenit 66 të VKM-se 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar "Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar", në keto kushte, oferta e bashkimit të



operatoreve "Everest" & "V.A.S. Konstruktion" refuzohet pasi gabimi aritmetik ne shume absolute eshte me shume se 2%.

- Shoqeria "V.A.S Konstruktion" sh.p.k: *nuk permbush kriterin sipas piken 2.3.3 Stafi inxhinierik (drejtues teknik) te perfshire ne licencen e shoqerise....Ing. Ismet Elezi i deklaruar si drejtues teknik per kete objekt eshte Ing. Hidroteknik dhe jo Ndertimi apo Mekanik.
- Nuk permbush kriteret sipas pikes 2.3.11 Deshmi per mjetet dhe pajisjet pasi * Fatura Nr. 24 date 30.08.2016 e paraqitur per mjetin Gjenerator nuk eshte e shoqeruar me foto te mjetit.
- Deklarata mbi disponueshmerine e mjeteve nuk eshte e rregullt pasi data e kontratave te qerases dhe deklaruar ne shtojce eshte i ndryshem nga data e kontratave te paraqitur ne SPE
- Kontrata e qerases se bashku me Mjetin me targa AA 179 VB i marre me qera nga Gjystina Cunaj nuk eshte deklaruar ne shtojce. (Te dhenat e mjetit dhe kontrates). Mjeti nuk ka foto dhe certificate pronesie.
- Nuk ka paraqitur asnje dokument pronesie ose me qera dhe foto per mjete dhe pajisje pune si, Set semaforesh per kontrollin e trafikut, Kone plastike, Matrapik, Betoniere.
- Eksperti zjarrfikes nuk disponon certificate nga Drejtoria e PMZSH, .
- Nuk ka te punesuar Manovrator per shtresat asfaltike.
- Nuk ka te punesuar Saldator.
 - Shoqeria " EVEREST" nuk permbush kriteret sipas pikes 2.3.11 pasi :
 - Per mjetin Autovinc AA806PY nuk ka paraqitur certificate transport malli -Nuk ka foto per mjetin kompresor, vetem dogane.
 - Per mjetin Kamion me targa TR9708P nuk ka paraqitur certificate transport malli.
 - Per mjetin me targa AA 595 PF nuk ka paraqitur certificate transport malli.
 - Nuk ka paraqitur dokumente provuese pronesie nga qeradhenesi per mjetet me qera makineri vijeziimi dhe batipal.
 - Mungon 1 batipal dhe 1 makineri vijeziimi. Nuk ka te dhena per te provuar kapacitetin e mjeteve dhe Ilojin e tyre.
 - Nuk ka paraqitur foto per makineri vijeziimi dhe batipal.
 - Mungon karrotreci.
 - NUK ka pirun, betoniere, kone plastike, litar me cikrik profesional per vijezim, sharre metalike prerese, set semaforesh per kontroll trafiku.
 - Eksperti zjarrfikes nuk eshte i certifikuar nga PMZSH.

III. Ne baze te Vedimit te KPP-se 802/2019 prot, date 24.12.2019 operatori ekonomik "R.S & M" & "SI.SI-AL" & "NDREGJONI" shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.



* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“I.D.K Konstruksion” SHPK**, me adresë: Tirane Vore Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Rruga Zaja, Koder Berxulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **38.915.179,17** (tridhjetë e tete milion e neteqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nete presje shtatëmbëdhjetë) leke pa tvsh , është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, Adresa: Rruga “Sami Frashëri nr.33”, Tiranë, Tel/Fax +355 4 2234789 / +355 4 2223600, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej () lekë , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.10.2019

Ankesa : PO

Më datë 5.11.2019 është paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor nga operatori ekonomik **“I.D.K Konstruksion” SHPK**. Më datë 11.11.2019 Autoriteti Kontraktor ka vendosur rrezimin e ankeses se paraqitur nga ky operator ekonomik dhe më datë 20.11.2019 “I.D.K-Konstruksion” SH.P.K i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin 802/2019 prot, date 24.12.2019 vendosi te pranoje ankesën e sipercituar, si dhe të anulojë vendimin e KVO-së, duke s’kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë “R.S & M” sh.p.k. & “SI-SI AL” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k .KPP me vendimin nr.**802/3/2019, date 30.12.2019 ka hequr pezullimi i procedures.**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys VERDHO

